



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 13.06.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Shpërblimi me kontratë si *Ekspert i Prokurimit* për ish-zyrtarin e lartë Selami Berisha nga institucioni ku ka ushtruar funksionin publik, pa kaluar dy vite nga përfundimi i funksionit të tij si (ish) udhëheqës i Prokurimit të Ministrisë së Ekonomisë, bie ndesh me dispozitën e nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në mbështetje të nenit 22, paragrafi 13, nenit 24, paragrafi 5, lidhur me nenin 19, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, dhe paragrafi 4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon shfuqizimin¹ e Kontratës me Nr.: 213-25-885-2-3-6, nga institucioni që e ka lëshuar atë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, inicion procedurë kundërvajtëse në gjykatën kompetente për shkak të shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- IV. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për ish zyrtarin e lartë Selami Berisha, tani Ekspert i Prokurimit në Ministrinë e Ekonomisë është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

¹ Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me rastin e kërkesës për shfuqizim të kontratës në fjalë ka pasur parasysh edhe dispozitat relevante për shfuqizim apo anulim diskrecionar të aktit administrativ, të Ligjit Nr. 05/L-031 të i Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas pranimit të një raportimi nga jashtë (RSQDWI-0053) me pretendimet se (citojmë):

“ [...] Arsyet e kësaj kërkesë kanë të bëjnë me dyshimin e bazuar për konflikt të interesit për ekspertin e prokurimit Selami Berisha. Kjo sepse ME, me datë 02.04.2025, ka publikuar njoftimin për nënshkrimin e kontratës me anë të të cilës kontraktin Selami Berisha në cilësinë e ekspertit të prokurimit në kuadër të ME. Raportuesi ka evidentuar se Selami Berisha është ish-udhëheqës i zyrës së prokurimit në ME, i cili është pensionuar me datë 16.01.2025 (këtë e konfirmon lajmi i publikuar në uebfaqen e ME). Fakti ë z. Berisha është ish-funksionar publik e konfirmon edhe regjistri i deklarimit të pasurisë për vitin 2023, në të cilën konfirmohet data e emërimit 02.05.2007. Raportuesi përveç që shpreh shqetësim për mënyrën se si është udhëhequr kjo procedurë e prokurimit në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, gjithashtu vlerëson që kjo kontratë është në kundërshtim me nenin 18 paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të Ligjit nr. 06/L për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku një zyrtar i lartë nuk mund të përfshihet në aktivitete kontraktuale pa kaluar dy vite, pas përfundimit të funksionit publik. Ndërsa, z. Berisha vetëm shtatëdhjetë e gjashtë ditë pas pensionimit ka nënshkruar kontratën me ME. [...]”.

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare (APK-DPKI-504/25), e ka njoftuar palën për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, është organizuar edhe një takim me palën Selami Berisha në zyrat e Agjencisë, me ç'rast i njëjti ka konfirmuar se pretendimet e ngritura janë të vërteta, porse nuk ka qenë në dijeni se një gjë e tillë është e ndaluar me ligj.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka siguruar dokumentacion/informacion të nevojshme (DPKI-645/25) nga Ministria e Ekonomisë si dhe dokumentacion tjetër relevant sipas detyrës zyrtare ku pas shqyrtimit dhe analizimit të të cilëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas kërkesës së Njësisë për Implementim të Projekteve nga Burimet e Ripërtitshme të Energjisë e datës 28.01.2025 dhe me aprovimin të ZKA ishte kërkuar inicimi i aktivitetit të prokurimit për “*Angazhim i Ekspertit të Prokurimit*”, bashkangjitur edhe *Specifikacioni teknik për angazhimin e ekspertit të prokurimit*”. Më pas, përmes Njoftimit për Kontratë të datës 14.02.2025 është iniciuar aktiviteti i prokurimit me titull: Angazhimi i Ekspertit të Prokurimit me numër të prokurimit: 213-25-885-2-3-6.

Me Vendimin të datës 25.02.2025, ishte formuar Komisioni i Vlerësimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë, për vlerësimin e ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit si më lartë. Komisioni i Vlerësimit përmes Raportit të Vlerësimit të Tenderëve të datës 24.02.2025, kishte rekomanduar dhënien e kontratës për Selami Berisha, ish-udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Ekonomisë, i cili raport kishte marrë miratimin edhe nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit z. Arbnor Hoxha.

Në bazë të rekomandimit në fjalë, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Arbnor Hoxha, kishte nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues nr. të Prokurimit: 213-258 85 236 i datës 26.02.2025, përmes të cilit ishte shpërblyer me kontratë personi fizik Selami Berisha, dhe atë vetëm shtatëdhjetë e gjashtë ditë (76) pasi që i njëjti kishte përfunduar punësimin si Udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Ekonomisë (Zyrtar i Lartë Publik).

Mbarimi i funksionit publik të z. Berisha është konstatuar edhe nga formulari i deklarimit të pasurisë, i cili më datë 30.01.2025 ka dorëzuar ne Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit formularin e Deklarimit pas Mbarimit apo Shkarkimit nga Funksioni.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e raportuesit të rastit që ka të bëjë me mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit e cila sipas raportuesit të rastit është bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka administruar asnjë provë dhe nuk është lëshuar ne trajtimi e këtij pretendimi pasi që i njëjti nuk hynë në sferën e konfliktit të interesit, përkatësisht është jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Pra, në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konstaton se përfshirja në marrëdhënie kontraktore drejtpërdrejtë e Selami Berisha me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik (si udhëheqës i Prokurimit të Ministrisë së Ekonomisë), pa kaluar dy (2) vite nga përfundimi i funksionit të tij publik, është në kundërshtim me nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

“1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:

1.2. të përfshihet në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm ose të besuar, me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik”.

Pra, në rastin konkret, Selami Berisha pa kaluar dy (2) vite pas përfundimit të funksionit publik si udhëheqës i Prokurimit të Ministrisë së Ekonomisë, *është përfshirë në marrëdhënie kontraktore, drejtpërdrejt, me institucionin ku i njëjti ka ushtruar funksionin publik* dhe kësisoj ka rënë ndesh me dispozitën e sipërcituar të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në mbështetje të nenit 22, paragrafi 13, nenit 24, paragrafi 5, lidhur me nenin 19, paragrafi 2 (nënparagrafi 2.5) dhe paragrafi 4, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si dhe në nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, kërkon shfuqizimin e Kontratës me Nr.: 213-25-885-2-3-6, nga institucioni që e ka lëshuar atë në kundërshtim me detyrimet që derivojnë nga dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në këtë mënyrë, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, dhe paragrafi 4 i nenit 19 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kanë përcaktuar se:

“2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuara dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësi të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen:

2.5. revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave”.

Ndërsa, me nenin 22, paragrafi 13 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përcaktuar se:

“ Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit.

Sikurse, neni 24, paragrafi 5 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përcakton se:

“Agjencia inicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi”.

Në zbatim të dispozitës pararendëse, me nenin 12 [Veprimet pas përfundimit të hetimit administrativ], paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, është përcaktuar se:

“1. Veprimet e Agjencisë në raport me epilogun e procedurës së zhvilluar të hetimit administrativ përfshijnë, por nuk kufizohen në:

1.5 Kërkesë për rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë”

Së fundmi, në kuptim të pikës II të dispozitivit të këtij vendimi, Ministria e Ekonomisë duhet ta njoftoj Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me veprimet e ndërmarra, konform neni 19, paragrafi 4, ku është përcaktuar se:

“Udhëheqësi ose institucioni udhëheqës njoftojnë Agjencinë për masat e marra për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive sipas këtij ligji”.

Përkatësisht, neni 22, paragrafi 11 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se:

“Organet kompetente njoftojnë Agjencinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e njoftimit për veprimet e ndërmarra prej tyre.”

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, për shkak të shkeljes së detyrimeve që derivojnë nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nga Selami Berisha, konkretisht mos zbatimit të kufizimeve të përcaktuara me nenin 18, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, lidhur me nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, do ta procedoj rastin në Gjykatën kompetente.

VI. Agjencia vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- ZKA-së së Ministrisë së Ekonomisë
- Palës (ish zyrtar i lartë Selami Berisha)
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


YLLI BULESHKAJ
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit